



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:032246

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05527151

**P.nr.116/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në lëndën penale ndaj të pandehurit B....I....., për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.129/2023 të datës 28.02.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 26.03.2024 në prezencën e Prokurorës së Shtetit, Ajtene Zoni, i pandehuri B....I....., mbrojtësja e të pandehurit, avokate Nadire Koshi, sipas detyrës zyrtare, e dëmtuara M....I....., mbrojtësi i viktimave Muhamet Pervetica si dhe interpretja e gjuhës së shenjave Zejnepe Sylejmani, me datë 29.03.2024 e shpalli publikisht dhe të njëjtën ditë e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri:

B....I....., me nofkën “V...”, nga i ati A....., e ëma T....., e vajzërisë A....., i lindur me datë 19.09.1972, në fshatin S.... i P...., Komuna e Mitrovicës, ku edhe jeton në shtëpinë e vëllait të tij, ka të kryer shkollën fillore, punon kohë pas kohe privat si punëtor-saldues, i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datë 04.03.2023, rreth orës 19:08 minuta, në fshatin Suhodoll i Poshtëm-Mitrovicë, me dashje seriozisht e kanosë të dëmtuarën-ish bashkëshorten (viktimë e ndjeshme) M....I....., me fjalë se do t’i shkaktojë ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit, si pasojë e mosmarrëveshjeve paraprake meqë të njëjtit janë në procesin e shkurorëzimit, në atë mënyrë që i pandehuri i shkon tek dera e shtëpisë ku e njëjta banon më fëmijët e tyre të mitur, ashtu që me të hapur derën i drejtohet me fjalët kërcënuese “*nëse shkurorëzohesh je e vdekur*” fjalë këto që kanë shkaktuar frikë dhe ankth në jetën e saj dhe të fëmijëve.

**Me këtë ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 71, 72 e lidhur me nenin 181 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 452 dhe 462 të KPP-së, e:

**G J Y K O N**

- I. DENIM ME BURGIM, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Në dënimin e shqiptuar, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak nga data 06.02.2023 deri 03.05.2023.
- II. Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. E dëmtuara, M....I....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.
- IV. Ndaj të akuzuarit, B....I....., Gjykata me aktvendim të veçantë i kishte ndërprerë masën e arrestit shtëpiak.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr 129/2023 të datës 28.02.2023, kundër të pandehurit B....I..... për shkak të veprës penale: Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.

Kjo Gjykatë, kishte caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 03.03.2023, në të cilën seancë i pandehuri ishte deklaruar i pafajshëm. Më pas, avokatja mbrojtëse kishte parashtruar kërkesë për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtim të provave, të cilat gjykata i kishte refuzuar dhe i cili vendim, ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës.

Gjykata për këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 26.03.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit, Ajtene Zoni, i pandehuri B....I....., mbrojtësja e të pandehurit, avokate Nadire Koshi, sipas detyrës zyrtare dhe e dëmtuara M.... I.....

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjenë veten fajtor për veprat penale, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimit të fajësisë,

pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimin te fajësisë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat lëndës dhe i ka propozuar gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë dhe këtë pranim te merr parasysh si rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

E dëmtuara, M.... I...., në shqyrtim fillestar dhe lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar: pajtohen që gjykata të bëjë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Mbrojtësja e të pandehurit B....I.....t, avokate Nadire Koshi lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar: i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin e saj.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit, me numër të rastit 2023-BC-138, i datës 04.02.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarëndëshmitaren M.... I...., 2023-BC-138, i datës 04.02.2024; Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin B....I....., 2023-BC-138, i datës 04.02.2024; Urdhri për mbrojtje e përkohshme emergjente, të datës 04.02.2023; Raporti i oficerit Florentina Hetemi, 2023-BC-138, i datës 04.02.2024; Raporti ditor i dhunës familjare, e datës 04.02.2024; Urdhër mbrojtje emergjente i lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-Divizioni Civil, C.nr. 163/23, i datës 06.02.2023; foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari, ka kryer veprën penale që i'u vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i 'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej një (1) viti deri në pesë (5) vite.

*Fjala përfundimtare e palëve:*

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare deklaroi se: pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare, i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor për veprën e kryer penale, ti shqiptoj një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ndërsa sa i përket rrethanave rënduese të merr parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikimin apo dëmtimin e vlerës së mbrojtur, faktin se kemi të bëjmë me viktimë të ndjeshme, vepra është kryer brenda marrëdhënies familjare si dhe sjelljen e mëparshme të të pandehurit.

Mbrojtësi i viktimave, në fjalën përfundimtare deklaroi: se e mbështet fjalën e përfundimtare të Prokurorit të Shtetit, ndërsa sa i përket kërkesës pasuror juridike i ka propozuar gjykatës që të dëmtuarën ta udhëzoj në kontest të rregullt civil për realizimin e saj ,për shkak se specifikimin e vlerës së dëmit nuk kemi arritur ta precizojmë dhe gjithashtu konsiderojmë se do ta zvarriste këtë procedurë.

E dëmtuara, M.... I....., në fjalën përfundimtare deklaroi: se e mbështet fjalën e Prokurorit të Shtetit dhe të mbrojtësit të viktimave dhe nuk kam tjetër se çfarë të shtoi.

Mbrojtësja e të pandehurit B....I.....t, avokate Nadire Koshi, në fjalën përfundimtare deklaroi se i propozon Gjykatës që me rasti e caktimit dhe llojit të dënimit të ketë parasysh rrethanat personale të personit të dënuar, fillimisht pranimin e fajësisë, keqardhjen e shprehur, sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar si dhe provokimin nga ana e viktimës tërë kohën.

I akuzuari B....I....., në fjalën përfundimtare deklaroi: i vije keq për rastin që ka ndodhur, dëshiron të kthehet me ish bashkëshorten, tashmë i kam kuptuar gabimet e mia, kujdesem për fëmijët e mi, e dërgoj vajzën në shkollë dhe e vetmja detyrë e imja është të rikthehem në shtëpi dhe të jetoj me bashkëshorten dhe fëmijët e mi dhe nga ky rast më nuk kemi pasur probleme.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethanë rënduese, gjykata mori parasysh faktin se i pandehuri edhe më parë ka qenë i dënuar me vendim të plotfuqishëm dhe atë përmes Aktgjykimit P.nr.419/2022, i plotfuqishëm me datë 02.11.2023. Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, ka shprehur keqardhje për rastin që ka ndodhur dhe i ka premtuar gjykatës se më asnjëherë nuk do të përsërisë veprime të tilla, rrethanat personale marrë parasysh se i njëjti është person familjar dhe baba i tre fëmijëve.

Gjykata në bazë të rrethanave të lartcekura, ka vlerësuar se të akuzuarit mund t'i zbutet dënimi konform dispozitave të neneve 71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është rrethanë e mjaftueshme që përmbushë kushtin e përcaktuar me dispozitën e nenit 71 par.1 nën paragrafi 1.3 e cila shprehimisht përcakton se gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit kur i pandehuri pranon fajësinë. Andaj në pajtim me dispozitën e nenit 72 par.1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së,

gjykata të akuzuarit ia ka zbutur dënimin për veprën penale për të cilën akuzohet dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi,

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me burgim me kusht ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen të pandehurit të përmbahen nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Gjykata me aktvendim të veçantë ndaj të akuzuarit i kishte ndërprerë masën e arrestit shtëpiak ndërsa vendimi për llogaritjen e kohës së kaluar në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar është marrë në bazë të nenit 79 par.1 të KPRK-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 462 të KPP-së ashtu që të dëmtuarën e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 242, 364, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr.116/2023, datë 29.03.2024**

Zyrtarja ligjore  
Doruntina BEKA

Gjyqtari  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.